

MODELI PËR DOKUMENTIN KONSULTATIV

Për draftin “Për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”:

(Përcaktoni/shkruani komentet e kujt po kërkon (veçanërisht), p.sh. komente (të përgjithshme) publike, nga komuniteti ekspert në fushën përkatëse, nga organet përfaqësuese të komunitetit të biznesit, nga organizatat joqeveritare dhe individët me përvojë në fushën përkatëse, etj.)

Projektligji është hartuar dhe koordinuar nga MSHMS me kontributin e Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës, të ngritur me Urdhrin e ministrit nr.179, datë 30.04.2025 “Për ngritjen dhe funksionimin e grupit teknik ndërinstitucional të punës për hartimin e ndryshimeve në Ligjin nr.9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar”.

Grupi i Punës përbëhet nga përfaqësues të MSHMS (Zëvendësministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në cilësinë e kryetarit, si dhe anëtarët: Drejtori i Përgjithshëm i Zhvillimit të Mbrojtjes Sociale; Drejtori i Përgjithshëm i Politikave të Shëndetësisë; Drejtori i Barazisë Gjinore; Drejtori i Programimit, Harmonizimit, Kuadrit Rregullator; Drejtori i Politikave të Përkujdesjes Sociale dhe Shërbimeve Sociale të Integruara), si dhe përfaqësues nga: Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Qëllim i këtij Projektligji është mbrojtja e viktimave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje përmes masave të përshtatshme ligjore, masave të tjera të nevojshme dhe politikave të integruara dhe gjithëpërfshirëse. Vëmendje e veçantë i kushtohet grupeve të cënueshme.

Ky projektligj i drejtohet të gjitha grupeve të interesit të cilat do të ndikohen nga ky projektligj dhe që kanë vendimarrje sa i përket fushës së mbrojtjes së dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimi i parë me grupin Teknik ndërinstitucional të punës për hartimin e ndryshimeve të projektligjit për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje u mbajt më 4 shtator 2025, ndërsa takimi I gjashtë dhe I fundit u mbajt më date 10 shtator 2025.

Projektligji është publikuar në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike më date 06 tetor 2025 deri më date 3 nëntor 2025, dhe ka marrë 565 shikimeve nga publiku i gjerë.

Si të përgjigjeni:

Shkruani si mund të përgjigjen palët e interesuara/publiku në konsultime, p.sh. Me email:, Me postë në:, Duke plotësuar formularin në internet në RENJKP (siguroni linket e drejtpërdrejta).

Pas hartimit të draftit të parë të projektligjit, u realizuan gjashtë (6) takime konsultuese publike me risitë e projektligjit, me të gjitha grupet e interesit të interesuara në fushën e parandalimit të të gjitha formave të dhunës, në bashkëpunim të ngushtë me ekspertet kombëtare dhe partnerët ndërkombëtarë si UNDP dhe UN Women. Më poshtë janë të listuara takimet e kryera me grupet e ndryshme të interesit, institucionet publike, institucionet e pavarura dhe organizatat e shoqërisë civile.

Projektligji për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje është publikuar në Regjistrin e Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike më datë 06 tetor dhe ka qëndruar hapur deri më 03 nëntor 2025.

Kërkesë për mendim për projektligjin i është dërguar me shkrim 33 institucioneve publike, institucione në nivel qendror dhe institucione të pavarura si Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Kontakti:

Znj. Sara Zaimi, Përgjegjës Sektori, Sektori i Luftës Ndaj Dhunës në Familje

Sara.zaimi@shendetesia.gov.al

Z. Xhenson Cela, Specialist Sektori i Barazisë Gjinore

Xhenson.cela@shendetesia.gov.al

Duhet të jepen të dhënat e kontaktit të koordinatorit përkatës për konsultime publike dhe /ose të ndonjë personi tjetër të cilit i drejtohen pyetjet.

Datat dhe vendet e takimeve publike:

Siguroni informacionin nëse ato janë të organizuar.

Vendi i takimeve për zhvillimin e konsultimeve publike me Grupin Teknik Ndërinstitucional të Punës dhe grupet e interesit, janë organizuar në mjediset e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, sipas grafikut më poshtë.

1. Takimi me Grupin Teknik Ndërinstitucional të Punës dhe përfaqësues nga ministrinë e linjës, INSTAT, Policia e Shtetit dhe Bashkia Tiranë (4 shtator 2025).
2. Takimi me Koordinatorët Vendorë kundër Dhunës në Familje (4 shtator 2025).
3. Takimi me përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile (8 shtator 2025).
4. Takimi me Institucionet e Pavarura për të Drejtat e Njeriut (9 shtator 2025).
5. Takimi me institucionet e teknologjisë dhe medias (10 shtator 2025).
6. Takimi me përfaqësues të sistemit të drejtësisë (10 shtator 2025).

Sfondi i propozimit legjislativ

Përshkruani pse ka nevojë për rregulloren e re/të ndryshuar, d.m.th cila është gjendja aktuale, si është e rregulluar, cilat janë sfidat, problemet dhe mangësitë ekzistuese si të praktikës, ashtu edhe të rregulloreve ekzistuese, çfarë është bërë në të kaluarën ashtu siç duhet me keto politika.

Nevoja për projektligjin e ri buron nga mangësitë e theksuara të kuadrit ligjor aktual, i cili është i kufizuar vetëm në trajtimin e dhunës në marrëdhëniet familjare dhe nuk adreson në mënyrë gjithëpërfshirëse format e tjera të dhunës ndaj grave që ndodhin në jetën publike, në vendin e punës, në mjediset digjitale apo në jetën politike. Ligji ekzistues nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, megjithëse është ndryshuar disa herë (me ligjet nr.

9914/2008, nr. 10 329/2010, nr. 47/2018 dhe nr. 125/2020), ka mbetur i pamjaftueshëm për të garantuar mbrojtje efektive dhe gjithëpërfshirëse ndaj të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore.

Aktualisht, fusha e zbatimit e ligjit është e kufizuar dhe nuk përfshin:

- dhunën e lehtësuar nga teknologjia (p.sh. shpërndarja e imazheve intime, përndjekja online, ngacmimi në internet);
- ngacmimin dhe ngacmimin seksual në marrëdhëniet e punës;
- dhunën ndaj grave në politikë apo në jetën publike;
- mbrojtjen e viktimave në situata konflikti, emergjencash apo jashtë kontekstit familjar.

Këto boshllëqe kanë bërë që viktimat e formave të tjera të dhunës, ndonëse të njohura si vepra penale, të mos gëzojnë masa civile ose administrative mbrojtjeje, si urdhra mbrojtjeje, masa parandaluese, apo shërbime të specializuara

Nga praktika institucionale dhe raportimet e organizmave kombëtarë e ndërkombëtarë, është evidentuar se:

- nuk ekziston një mekanizëm i unifikuar raportimi dhe reagimi ndërinstitutional;
- mungon një sistem i koordinuar ndërmjet strukturave të drejtësisë, policisë, shërbimeve sociale dhe organizatave të shoqërisë civile;
- mbrojtja ligjore nuk është e aksesueshme në kohë dhe shpesh pengohet nga procedura të gjata gjyqësore ose mungesa e informimit të viktimave;
- trajnimet e profesionistëve (polici, gjyqtarë, punonjës socialë, mjekë) nuk janë të standardizuara;
- mungon adresimi i paragjytimeve gjinore dhe viktimizimit dytësor, veçanërisht në media dhe opinion publik

Ndryshimet e pjesshme të bëra ndër vite kanë përmirësuar disa procedura (si urdhrat e mbrojtjes dhe detyrimet e raportimit), por nuk kanë mundur të përfshirjen e plotë të të gjitha formave të dhunës ndaj grave, siç kërkojnë Konventa e Stambollit, Konventa CEDAW, Konventa ILO nr.190 dhe Direktiva (BE) 2024/1385.

Projektligji i ri synon:

Të zëvendësojë ligjin ekzistues me një kuadër gjithëpërfshirës, që mbulon të gjitha format e dhunës ndaj grave në çdo sferë të jetës;

- të forcojë mekanizmat institucionalë të bashkëpunimit në nivel qendror dhe vendor;
- të sigurojë qasje të menjëhershme dhe falas në drejtësi;
- të zbatojë standarde të reja për mbrojtje digjitale, politike dhe në punë;
- të sigurojë përafrim të plotë me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe me instrumentet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë

Propozimet

Renditni dhe përshkruani në mënyrë të shkurtër dhe koncize të gjitha propozimet dhe ndryshimet që doni të prezantoni me rregulloren e reja. Përdorni një gjuhë të thjeshtë.

Projektligji i ri për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje sjell një sërë ndryshimesh të rëndësishme krahasuar me ligjin ekzistues. Ai zgjerohet përtej dhunës në familje dhe përfshin të gjitha format e dhunës ndaj grave, në jetën publike dhe private, përfshirë mjediset e punës, arsimin, shëndetësisë, sportit, politikës dhe internetit. Ligji i ri synon të garantojë mbrojtje për çdo viktimë, pavarësisht gjinisë apo statusit, duke përfshirë edhe fëmijët dëshmitarë të dhunës, shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi

Në përmbajtjen e tij, projektligji përfshin përkufizime të reja ligjore dhe parime të qarta si qasja me në qendër viktimën, respektimi i privatësisë dhe ndalimi i ndërmjetësimit në rastet e dhunës me bazë gjinore. Ai detajon format klasike të dhunës: fizike, psikologjike, ekonomike dhe seksuale, dhe shton forma të reja si **dhuna e lehtësuar nga teknologjia, ngacmimi seksual dhe dhuna ndaj grave në politikë**. Parashikohet një kuadër i posaçëm për rastet e dhunës digjitale, duke adresuar shpërndarjen e imazheve intime, përndjekjen online dhe gjuhën e urrejtjes në internet, si dhe duke vendosur masa civile dhe administrative për mjediset digjitale

Ligji propozon krijimin e një rrjeti të koordinuar institucional për bashkëpunim ndërmjet autoriteteve qendrore, vendore dhe aktorëve privatë, forcimin e mekanizmave gjyqësorë për masa të menjëhershme mbrojtjeje dhe garantimin e qasjes falas në drejtësi për viktimat. Ai parashikon gjithashtu detyrimin për trajnime profesionale për policinë, gjyqtarët, punonjësit socialë dhe profesionistë të tjerë, mbledhjen dhe publikimin e statistikave zyrtare mbi dhunën në bashkëpunim me INSTAT, si dhe përfshirjen e sektorit privat në masat parandaluese.

Në thelb, projektligji i ri synon të modernizojë dhe zgjerojë mbrojtjen ligjore ndaj dhunës me bazë gjinore, të sigurojë reagim të shpejtë dhe efektiv ndaj rasteve të dhunës dhe të harmonizojë kuadrin ligjor shqiptar me standardet dhe direktivat e Bashkimit Evropian.

Pyetjet

Listoni pyetje për të cilat po kërkon reagime. Ato mund të lidhen me propozimet tuaja (p.sh. A jeni dakord me propozimin për ..., A jeni dakord që duhet të ndërmerren veprime të mëtejshme për të parandaluar/rritur ..., A jeni dakord që ne e quajmë shkelje ..., A pajtoheni me përkufizimin tonë të ri për ..., etj.) ose thjesht përdoren për të mbledhur të dhëna shtesë që ju kërkon (p.sh. Cili do të ishte ndikimi i propozimeve tona në biznesin tuaj, organizatat, A e bën organizata juaj ..., etj.). Ju mund të merrni parasysh kufizimin e gjatësisë së përgjigjeve për pyetjet individuale (p.sh. 250/500 fjalë).

- 1. A jeni dakord që ligji i ri të zgjerojë fushën e tij për të mbuluar të gjitha format e dhunës ndaj grave, përfshirë ato që ndodhin në mjediset publike, në vendin e punës, në arsim, në politikë dhe në hapësirat digjitale?*
- 2. A pajtoheni që përkufizimet e reja, si “dhunë ndaj grave”, “provë digjitale” dhe “qasja me në qendër viktimën”, e bëjnë ligjin më të qartë dhe më të zbatueshëm në praktikë?*
- 3. A mendoni se raportimi online dhe mundësia për raportim nga çdo person, jo vetëm nga viktimat, do të ndihmojnë në rritjen e reagimit të shpejtë dhe mbrojtjes së viktimave?*
- 4. A jeni dakord që të krijohen **vlerësime individuale për çdo viktimë** dhe që mbështetja të përshtatet sipas nevojave të saj specifike?*

5. A mbështesni **trajnimet e detyrueshme për profesionistët** (polici, gjyqtarë, mjekë, punonjës socialë, gazetarë) për të përmirësuar reagimin institucional dhe shmangur viktimizimin dytësor?
6. A jeni dakord që të vendoset **monitorim elektronik për dhunuesit** në rastet e rrezikut të lartë, për të garantuar sigurinë e viktimës?
7. A e konsideroni të nevojshme përfshirjen e sektorit privat dhe mediave në parandalimin dhe raportimin e dhunës ndaj grave?
8. Cilat mendoni se do të jenë sfidat kryesore të zbatimit të ligjit të ri në nivel lokal dhe institucional?
9. Cili do të ishte ndikimi i propozimeve të reja në punën e institucioneve apo organizatave që ju përfaqësoni (p.sh. në aspektin e burimeve njerëzore, buxhetit, koordinimit ndërsektorial)?